



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 186, Datë 20.08.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 74 SERIA T08P,
TË SHOQËRISË “GEN – I TIRANA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Gen – I Tirana” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për rinovimin licencës në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 523 Prot., datë 26.07.2018.
- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: *Tregtim energjie elektrike sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për sektorin e energjisë elektrike si dhe cdo aktivitet tjetër për shkak dhe të lidhur me objektin e mësipërm.*
- Shoqëria “Gen – I Tirana” sh.p.k., zotëron licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike që prej datës 02.12.2008 me vendim të Bordit të ERE-s, nr 130, me Seri licence T08P dhe nr. licence 74. Pas përfundimit të këtij afati, shoqërisë së sipërcituar i është rinovuar licenca në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 105, datë 01.10.2013.
- Në prag të përfundimit të afatit kohor të licencës, shoqëria “Gen – I Tirana” sh.p.k., kërkon rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në bazë të nenit 16, pika 1 (*Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së*

vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentat përkatëse) të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, është plotësuar nga aplikanti pjesërisht, pasi rezulton që shoqëria “Gen – I Tirana” sh.p.k., ka depozituar vetëm bilancin e vitit 2017 dhe jo bilancet e tre viteve të fundit siç kërkohet nga neni 9, pika 3, germa b) të Rregullores.
- Dokumentacioni Teknik për veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike është plotësuar nga aplikanti në mënyrë korrekte.
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3, germa b) do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 74 seria T08P, të shoqërisë “Gen – I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI